



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:040385
Datë: 29.02.2024
Numri i dokumentit: 05392551

PPP.nr.2052/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditores Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Prishtina" Sh.A, me seli në Prishtinë, Rr. "Hazir Shala" nr.4, kundër debitorit M.M nga P, Rr. "I.K" nr..., lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga ana e debitorit, kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr.81/19, të datës 19.09.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat S.R në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 29.02.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit M.M nga P, i ushtruar kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr.81/19, të datës 19.09.2019, të lejuar nga Përmbartuesit Privat S.R në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- II. Në rast se pala debitore parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, OBLIGOHET që në afat prej 7 (shtatë) ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 733.46 €.
- III. Në rast se pala debitore dështon të paguajë shumën e lartëcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat S.R në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditores Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Prishtina" Sh.A, me seli në Prishtinë, ka lëshuar Urdhërin Përmbartimor P.nr.81/19, të dt.19.09.2019, me të cilin është obliguar debitori M.M, që në emër të shërbimeve publike - furnizimin me ujë të pijshëm t'i paguajë kreditorit borxhin në shumë prej 733,46 €, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të Urdhërit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër Urdhërit Përmbarrimor të lartëcekur, brenda afatit të përcaktuar ligjor prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësimin e parashtruar, ndër tjera pretendohet se debitori e kundërshton në tërësi urdhërin për caktimin e përmbarrimit ngase shuma prej 733.46 euro, në emër të shërbimeve publike - furnizimit me ujë të pijshëm i përket viteve paraprake, duke filluar nga viti 2013, 2014, 2015 dhe 2016, ku kemi të bëjmë me parashkrim, në referim të dispozitës së nenit 360 par.1 të Ligjit për Marrdhëniet e Detyrimeve. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi ndërsa të anulohet urdhëri përmbarrimor i goditur me prapësim.

Përgjigje në prapësimin e ushtruar nga ana e debitorit ka paraqitur pala kreditore. Në përgjigje ndër tjera pretendohet se pretendimet e debitorit sa i përket parashkrimit nuk qëndrojnë, për faktin se i njëjti ka pranuar shërbimet e ujësjellësit dhe ka bërë marrëveshjen e ri-programimit të borxhit, të cilës marrëveshje nuk i është përmbajtur. Tutje pala kreditore i është referuar dispozitës nga neni 368 të Ligjit për Marrdhëniet e Detyrimeve, në të cilën parashihet se parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin dhe pranimi mund të bëhet jo vetëm me deklaram, por edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse pagesa e kështit etj. Me tej, janë kundërshtuar pretendimet e debitorit të cekura në prapësim, mbi bazën e faktit se të njëjtat bien ndesh me gjendjen faktike, andaj është propozuar që prapësimi të refuzohet në tërësi si i pa bazuar.

Gjykata pas vlerësimit me kujdes dhe vëmendje të pretendimeve të palës debitore të parashtruara në prapësim, pretendimeve të palës kreditore të parashtruara në përgjigje në prapësim, si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi është i pa bazuar, mbi bazën e arsyeve si në vijim:

Dispozita nga 21 e Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (tani e tutje LPP), e cila i referohet bazës juridike për caktimin e përmbarrimit, parasheh që: "*Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*". Në anën tjetër, dispozita e nenit 29 par.1 e LPP-së përcakton llojet e dokumenteve të besueshme, mbi bazën e të cilave mund të caktohet përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla, duke përcaktuar se: "*Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*". Paragrafi 3 i të njëjtës dispozitë përcakton: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë e kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, ndërsa mungesa e njërit prej tyre, rrjedhimisht ia heqë dokumentit të besueshëm cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbarrim.

Në rastin konkret, propozimi për përmbarrim është paraqitur duke u mbështetur në kartelën financiare të konsumatorit, nën shifrën 56398. Nga vështrimi i këtij dokumenti, Gjykata vlerëson se i njëjti paraqet ekstrakt të verifikuar nga librat afaristë të kontabilitetit, përmban të dhëna për kreditorin dhe debitorin, si dhe është përcaktuar objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Në bazë të zbërthimit të aspekteve të tilla, rrjedh se dokumenti i lartëcekur i përmbushë të gjitha kriteret e kërkuara ligjore për të shërbyer si bazë për caktimin e përmbarrimit, në kuptim të dispozitës nga neni 29 të LPP-së.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e ngritura nga ana e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës në kuptim të dispozitës së nenit 341 par.3 të LMD-së dhe lidhur me pretendimet e tilla iu referua dispozitës nga neni 360 par.1 nënpar.1 të LMD-së, e cila parasheh se: “Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti janë: “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake dhe par.2 ku përcaktohet “Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”.

Në rastin konkret, bëhet fjalë për borxhin e akumuluar për periudhën kohore 01.01.2013 deri me dt.06.09.2019. Nga interpretimi i dispozitës së lartëcekur nga neni 360 par.1 nënpar.1 lidhur me par.2 të LMD-së, Gjykata fillimisht sjellë në vëmendje se borxhi i akumuluar për vitin kalendarik 2013, mund të kërkohet më së voni deri me dt.31.12.2014, pasi me kalimin e një periudhe të tillë konsiderohet i parashkruar. Interpretimi i njejtë vlen edhe për periudhën vijuese. Në anën tjetër, nga shkresat e lëndës, specifikisht kartela financiare e konsumatorit nën shifrën 56398, Gjykatës i rezulton se debitori ka bërë pagesa të kohë pas kohshme (duke filluar nga pagesa e dt.31.12.2013, në shumë prej 726.00 €; pagasa e dt.15.01.2015, në shumë prej 40.00 €; pagesa e dt.06.05.2015, në shumë prej 150.00 €; pagesa e dt.15.10.2015, në shumë prej 70.00 €; pagesa e dt.01.09.2016, në shumë prej 100.00 €; pagesa e dt.11.09.2017, në shumë prej 27.00 €; pagesa e dt.14.09.2017, në shumë prej 50.00 €; pagesa e dt.06.10.2017, në shumë prej 20.00 €; pagesa e dt.21.12.2017, në shumë prej 20.00 €; pagesa e dt.05.01.2018, në shumë prej 20.00 €; pagesa e dt.12.02.2018, në shumë prej 15.00 €; pagesa e dt.16.04.2018, në shumë prej 30.00 €; pagesa e dt.11.05.2018, në shumë prej 28.50 €; pagesa e dt.09.08.2018, në shumë prej 15.00 €; pagesa e dt.17.09.2018, në shumë prej 23.00 €; pagesa e dt.15.10.2018, në shumë prej 22.00 €, si dhe pagesa e dt.17.12.2018, në shumë prej 20.00 €.

Përmes këtyre veprimeve, Gjykata vlerëson se ka ardhur në shprehje ndërprerja e parashkrimit, në kuptim të dispozitës nga neni 368 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Ligji nr. 04/L-077, ku përcaktohet: “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.” Si rezultat i një interpretimi të tillë, vlerësimi përfundimtar i Gjykatës konsiston në faktin se afati i fundit për kreditorin për të kërkuar përmbushjen e detyrimit në raport me debitorin është data 31.12.2020. Bazuar në faktin se propozimi për përmbarim është paraqitur me datën 19.09.2019, rrjedh se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës në këtë çështje përmbarimore. Në anën tjetër, nga kartela financiare e konsumtaorit, Gjykata vërtetoi faktin se pas zbritjes së shumës së borxhit e cila është paguar nga shuma e tërësishme e borxhit brenda periudhës së specifikuar, borxhi i mbetur rezulton të jetë në shumën prej 733.46 €,

Bazuar në këto fakte, Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, në pajtim me nenin 73 par.2 dhe 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, e ka refuzuar prapësimin e debitorit, duke e lënë në fuqi Urdhërin Përmbarimor të goditur me prapësim.

Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi palën debitore që në rast të parashkrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 733.46 €, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën III të dispozitivit e paralajmëroi të njejtin se në rast të dështimit të pagesës

së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Mbi bazën e të lartëcekurave, në mbështetje të dispozitës nga neni 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL-
PPP.nr.2052/19, datë 29.02.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 77 të LPP-së është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.